

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DËFTESAT TREGTARE MBI PRODUKTET BUJQËSORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është që të sigurojë sa më shumë financime në bujqësi, pagesa të shpejta dhe të drejta për fermerin për produktin bujqësor të ardhshëm dhe atë të magazinuar, si dhe krijimin e një sistemi kolateral nëpërmjet produktit bujqësor të ardhshëm dhe atij të magazinuar. Në këtë projektligj rregullohen në mënyrë specifike dy instrumentet financiare si “dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm” dhe “dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar”, procedura elektronike e lëshimit të këtyre dëftesave, regjistrimi i tyre në formë elektronike, si dhe në regjistrin e barrëve siguroese.

Me anë të këtij projektligji synohet që: (i) të rriten financimet në bujqësi; (ii) fermerët të nxiten të kultivojnë dhe të prodhojnë sa më shumë produkte bujqësore; (iii) një financim paraprak për fermerin, si dhe garantim i kreditorit për t’u paguar në lekë apo në natyrë, me produktin bujqësor të ardhshëm; (iv) rregullim juridik i marrëdhënies mes fermerit dhe grumbulluesit të produkteve bujqësore, duke mundësuar që fermeri të paguhet për produktin, që në çastin e grumbullimit apo në një moment më të vonë, kur çmimi i shitjes së produkteve të jetë më i lartë. Pra në analizë të fundit synohet krijimi i një zinxhiri financimi më të mirë për subjektet e përfshira në sektorin bujqësor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE LIGJORE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Zhvillimi i një bujqësie ekstensive, mbi baza shkencore, e mirëfinancuar ka qenë pjesë e objektivave vijuese të programit politik të Këshillit të Ministrave, politikë qeveritare e shprehur edhe me vendimin nr. 460, datë 29. 06. 2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027”.

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, pasi vjen si një sugjerim i partnerëve ndërkombëtarë IFC/ WB, pas studimit të praktikave të mira ndërkombëtare në fushën e financimit të bujqësisë, si dhe pas studimit të praktikave të brendshme në këtë fushë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj hartohet për herë të parë në vendin tonë. Në vendet e tjera ka një traditë të konsoliduar në lidhje me këto instrumente financiare mbi produktet bujqësore. Në rastin konkret janë marrë në konsideratë traditat ligjore të krijuara për të rregulluar këto marrëdhënie juridike në Brazil, Ukrainë, etj. Në këto shtete fermerët e vegjël janë përballur me problematikën e pamundësisë për të marrë kredi duke përdorur produktin bujqësor si kolateral dhe aty e ka gjenezën thelbi i projektligjit të propozuar. Kështu në Brazil, që në vitet '60 u miratua koncepti i "premtimit për të paguar" (*Promisory Note*) si mënyrë e financimit të bujqësisë, përpara vjeljes së produktit dhe pas magazinimit të produkteve bujqësore. Fillimisht kjo mënyrë financimi u përdor nga bankat, të cilat mbështeteshin nga qeveria për të financuar fermerët. Me rënien e mbështetjes financiare nga qeveria u gjetën alternativa të tjera të financimeve private dhe në vitin 1994 u miratua në Brazil instrumenti i ri "*Cedula de Prodoto Rural*" (*CPR*) që janë titujt mbi produktin rural, si mënyrë financimi në bujqësi mënyrë e cila solli hov në zhvillimin e bujqësisë në këtë shtet. Po ashtu në Ukrainë një ligj i ngjashëm është miratuar në vitin 2012, bazuar në modelin e sukseshëm të Brazilit dhe si mënyrë për të ndihmuar me financime fermerët e mesëm dhe të vegjël. Rezultati në Ukrainë ishte që në gjashtë vite mbi 3500 fermerë lëshuan mbi 7100 tituj mbi produktet bujqësore dhe tejkalluan mbi 1.7 miliardë dollarë financime.

Gjatë procesit të hartimit të këtij projektligji, në vendin tonë është punuar paralelisht dhe në bashkëpunim me ekipet e ngritura në shtetet fqinje për hartimin e të njëjtin ligj si në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, duke synuar një rregullim juridik gati të njëjtë, për instrumentet financiare mbi produktet bujqësore, në të tre vendet.

Projektligji është modern dhe praktik, pa kosto të shtuara për fermerët apo subjektet e tjera të përfshira, si: grumbulluesit, eksportuesit, agropërpunuesit, furnizuesit e lëndëve të para, investitorët, etj. Procedura për lëshimin e këtyre dëftesave tregtare është parashikuar të jetë elektronike, në platformën shtetërore e-Albania, pa tarifa, duke kryer në të njëjtën kohë online edhe regjistrimin si barrë siguroese të këtyre dëftesave.

Efekti primar që pritet të sjellë në zbatim ky projektligj do të jetë shtimi i financimit në bujqësi, rritja e sipërfaqes së kultivuar në vend, rritja e ndjeshme e sasisë dhe përmirësimi të cilësisë së produkteve bujqësore, një funksionim më i mirë i gjithë zinxhirit të produkteve bujqësore, që nga çasti i mbjelljes së fidanëve/ farave e deri në çastin e shitjes apo përpunimit të produkteve bujqësore. Si efekt indirekt pritet që projektligji të ndikojë për mirë duke shmangur problemin e shkaktuar deri tani nga copëzimi i skajshëm i tokës bujqësore. Pra

efektet e pritshme pozitive janë të shumta me impakt në rritjen ekonomike në sektorin e bujqësisë, rritje të mirëqënies së fermerëve, si dhe të subjekteve të tjera, të përfshira në këtë sektor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe në harmoni me legjislacionin vendas.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me Acquis Communautaire.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i konceptuar në gjashtë krerë e konkretisht në: dispozitat e përgjithshme, dëftesat tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, dëftesat tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar, regjistri elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, përmbushja e detyrimeve dhe ekzekutimi i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, si dhe dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Kreu I- Dispozita të përgjithshme- Në kreun e parë përfshihet objekti dhe qëllimi i projektligjit, ndërsa në një dispozitë më vete përkufizimet e termave të përfshira në të, si p.sh: “Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm”, “Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar”, “Regjistri elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore”, etj.

Kreu II- Dëftesat tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm- Në këtë kre parashikohen dispozitat që kanë të bëjnë me të dyja llojet e dëftesave tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, njëra me kthim shume dhe tjetra me shkëmbim në prodhim. Përveç elementëve të domosdoshëm, që duhet të përmbajë dëftesa tregtare, në këtë kre janë parashikuar edhe garancitë që ka kreditori për ta marrë shumën e investuar në produktin bujqësor të ardhshëm, si dhe mundësia për ta monitoruar kolateralin e kësaj dëftese. Po ashtu në këtë kre gjen rregullim edhe se si bëhet kontrata e qirasë për tokën bujqësore duke e lidhur me

parashikimet e Kodit Civil. Në këtë kre është parashikuar edhe kompetenca e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që në zbatim të këtij ligji të miratojë formatin tip të këtyre dëftesave tregtare.

Kreu III- Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar- Edhe në këtë kre parashikohen dispozita në lidhje me përmbajtjen e dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar, procedura elektronike e përpilimit të këtij akti, elementët përbërës për vlefshmërinë e tij, etj. Kjo dëftesë tregtare lëshohet me kërkesën e depozituesit të produkteve bujqësore, pasi e ka lidhur një kontratë me magazinuesin. Terminologjia ligjore në lidhje me kontratën e magazinimit është e unifikuar me atë të Kodit Civil. Nisur nga rëndësia që kanë këto magazina, si subjekte të zinxhirit ushqimor, por dhe financiar me lëshimin e këtyre dëftesave tregtare është parashikuar edhe kompetenca e Këshillit të Ministrave, që të miratojë me vendim kushtet minimale, të detyrueshme për t'u zbatuar nga magazinuesi, në mënyrë që të lëshojë dëftesa tregtare.

Kreu IV- Regjistri elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore- Në këtë parashikohen dispozita në lidhje me krijimin, funksionimin dhe përmbajtjen e regjistrit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, cilat të dhëna përmban ky regjister, si ruhen këto të dhëna, vlefshmëria e regjistrimit, etj.

Kreu V- Përmbushja e detyrimeve dhe ekzekutimi i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore- Në këtë kre parashikohet se kur konsiderohet i përmbushur detyrimi i marrë përsipër me këto dëftesa tregtare. Nisur edhe nga përkufizimi i bërë që tek dispozita “Përkufizime”, që këto dëftesa tregtare konsiderohen tituj ekzekutivë, në kuptimin e nenit 510, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të regjistruar si barrë siguruese, në kuptimin e nenit 25, të ligjit nr. 8537, datë 18. 10. 1999 “Për barrët siguruese”, i ndryshuar, atëherë ekzekutimi i tyre i detyrueshëm në rast mospërmbushje vullnetare të detyrimit nga ana e debitorit është i lidhur me vetë ligjin “Për barrët siguruese.”, si një mënyrë ekzekutimi më e shpejtë, nisur nga specifika, që kemi të bëjmë me kolateral biologjik, siç janë prodhimet bujqësore. Në këtë kre parashikohet edhe një mekanizëm zgjidhjeje mosmarrëveshjes i shpejtë dhe jashtëgjyqësisht, i cili synon t’iu ofrojë palëve zgjidhje të shpejtë, profesionale për fushën e bujqësisë dhe pa kosto për ta.

Kreu VI- Dispozitat kalimtare dhe të fundit- Në këtë kre parashikohen rastet se kur dhe si zbatohen ligjet e tjera, në rastet kur ky projektligj nuk parashikon ndryshe. Po ashtu parashikohet detyrimi i Këshillit të Ministrave për të miratuar aktet nënligjore brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e ligjit në fuqi, si dhe brenda një viti të vërë në funksionim të regjistrit elektronik të dëftesave tregtare në platformën e-Albania.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Agjencia Kombëtare Shqiptare e Informacionit.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Hartimi i këtij projektligji është kryer nga grupi i punës i ngritur nga Ministri i Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural në bashkëpunim me WB/ IFC dhe SEECO. Grupi i punës përbëhej gjithashtu edhe nga përfaqësues nga Banka e Shqipërisë dhe AKSHI. Ndërkohë një kontribut të vyer në procesin e hartimit të projektligjit kanë dhënë edhe subjektet si më poshtë:

- **Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare** me sugjerimet përkatëse, që këto dëftesa tregtare të lëshuara nga fermerët apo magazinuesit e produkteve bujqësore, si ndihmëse për aktivitetin e tyre apo si derivative të mallrave në kuptimin e nenit 10, pika 2, shkronja “e” të ligjit nr. 62/ 2020 “Për tregjet e kapitalit” përjashtohen nga kërkesa për licencim, njohje apo regjistrim, sipas këtij ligji. Një kërkesë e tillë për zbatimin e ligjit si më lart, iu lind subjekteve që do t’i tregtojnë këto dëftesa në një treg të rregulluar, në një platformë shumëplanëshe apo në një treg mbi banak (OTC).
- **Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë** me propozimet e dërguara për ta përmësuar projektligjin në lidhje me garancitë e dëftesës tregtare, si dhe për monitorimin vazhdues të kolateralit.
- **Shoqata Shqiptare e Bankave** me sugjerimet e shumta, si dhe me propozimin e tyre, që ndër subjektet që mund të lëshojnë dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm të jenë edhe fermerët e pajisur me kartë fermeri, si ndihmesë dhe fazë e ndërmjetme e tyre, që të kalojnë nga subjekte pa detyrime tatimore në formalizim të plotë si subjektet e tjera.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ka kosto financiare të llogaritura për ngritjen e njësisë përgjegjëse në strukturën e ministrisë. Kosto mujore për një sektor minimal 1+2, një përgjegjës sektori e dy specialiste afro 368 mijë page mujore shtu sigurimet e shtetit, për 12 muaj. Kostot për 3- vitet e para të zbatimit

të ligjit do të përballohen nga mbështetja e IFC dhe SEECO. Pas tre vitesh regjistri i ngritur do të mirëmbahet nga AKSHI.